VENDIM
Nr.527, datë 20.7.2011

PËR PËRCAKTIMIN E PAGËS MINIMALE NË SHKALLË VENDI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 111 të ligjit nr.7961, datë 12.7.1996 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" dhe të nenit 4 të ligjit nr.10 405, datë 24.3.2011 "Për kompetencat në caktimin e pagave dhe shpërblimeve", me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Paga bazë minimale mujore, për punonjësit, në shkallë vendi, që është e detyrueshme të zbatohet nga çdo person, juridik a fizik, vendas ose i huaj, të jetë 20 000 (njëzet mijë) lekë.
2. Paga bazë minimale mujore jepet për 174 orë pune në muaj, të kryera gjatë kohës normale të punës.
3. Paga bazë minimale orare të jetë 115 (njëqind e pesëmbëdhjetë) lekë.
4. Shtesat me karakter të përhershëm jepen mbi pagën bazë.
5. Vendimi nr.566, datë 14.7.2010 i Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e paës minimale në shkallë vendi", shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2011.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha